

Drejtuar: Internews Kosova

z. Faik Ispahiu, Kryeredaktor

z. Kreshnik Gashi, Redaktor menaxhues

Nga: Liridon Kurti

Përmes postës elektronike: info@kallxo.com

Lënda: Ankesë/Reagim ndaj artikullit „Propaganda fetare që kërcënon Kosovën“ të publikuar nga „Kallxo.com“ (vegëza: <https://kallxo.com/gjate/propaganda-fetare-qe-kercenon-kosoven/>)

I nderuar z. Ispahiu,

I nderuar z. Gashi,

më lejoni që përmes kësaj parashtrese të demantoj të pavërtetat e përmendura në shkrimin e lartpërmendur dhe të kërkoj nga Ju që:

1. Të korrigjoni shkrimin tuaj dhe të fshini të pavërtetat ndaj meje
2. Të botoni reagimin tim
3. Të kërkonit falje për keqinformim dhe shpifje.

Në artikullin e publikuar nga mediumi juaj, ju parashtroni në paragrafin e mëposhtëm disa të pavërteta.

Teksti original nga artikulli juaj:

“Gjatë vitit në vend pati disa nisma të cilat dëshmonin tentativa për shtrirjen e islamit politik në insitucionet arsimore. Duke interpretuar kushtetutën e Kosovës, Ministria e Arsimit ka nxjerrë një udhëzim administrativ me të cilin ndalon përdorimin e shamisë në shkolla. Një person me profil të bamirësit nga Mitrovica nisi një fushatë për ndryshimin e rregullores. Liridon Kurti personi që e nisi këtë nismë mori 37 mijë shprehëtarje në rrjetet sociale, ndërsa nisma u përkrah edhe nga deputetë e politikanë. Pas presionit publik, kryeministri Albin Kurti dha një qëndrim të ri sa i përket shamisë. Ai tha se shamia do duhej të lejohet mbi moshën 16 vjeçare.”

1. Nisma ligjore (kërkesa formale) nuk është iniciuar nga z. Liridon Kurti

Është fakt notor se kërkesa formale për anulimin e dispozitës kontestuese të Udhëzimit Administrativ Nr. 96/2014 është dorëzuar nga juristi Durim Berisha (i cili nuk përmendet fare në artikullin tuaj). Kërkesa është arsyetuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe në të vërtetë kërkon eliminimin e një dispozitë të paligjshme dhe pakushtetuese.

2. Kërkesa nuk ka pasur asnjëherë tentativë për shtrirjen e islamit politik në shkolla

Artikulli juaj në tërësi shprehë një të pavërtetë të qartë, pra është një shpifje dhe dezinformim total. Kërkesa formale e as kampanja në rrjetet sociale nuk ka pasur asnjëherë konotacion apo qëllime qoftë të hapura apo të fshehta të kësaj natyre. Kërkesa dhe kampanja kanë pasur për qëllim eliminimin e një dispozite të paligjshme (ashtu si theksonte dikur edhe vet Kryeministri Kurti se nuk është ne pyetje lejimi i shamisë në shkolla, por eliminimi i një pengese të paligjshme).

Kërkesa e dorëzuar në MASHTI i referohet edhe standardeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave liritë dhe të drejtat themelore nuk mund të kufizohen me akte nënligjore, por vetëm me ligj. Në rastin konkret është kërkuar anulimi i një dispozite absolutisht të pavlefshme e cila vetëm krijon debate e zhurma në çdo fillim të vitit të ri shkollor.

Duhet theksuar edhe njëherë se çka është “islami politik”. Sipas një botimi të “Oxfordit”, “Termi islam politik i referohet në përgjithësi çfarëdo interpretimi të islamit që shërben si bazë për identitet apo veprim politik. Më saktësisht, i referohet lëvizjeve që përfaqësojnë mobilizime moderne politike në emër të islamit, një prirje që u shfaq në fund të shekullit 20”.¹

Është fakt notor se as kërkesa e dorëzuar në MASHTI e as kampanja **nuk është bazuar në “asnjë interpretim të islamit”, nuk ka shërbyer si “bazë për identitet apo veprim politik” dhe nuk ka paraqitur “një lëvizje të mobilizimit modern politik”,** rrjedhimisht artikulli juaj në tërësi bazohet në konstatime të pavërteta që keqinformojnë publikun dhe përhap shpifje për z. Liridon Kurtin dhe kërkesën/kampanjën, të cilat kanë qenë të bazuara në argumente kushtetuese dhe ligjore, pra që në të vërtetë kanë promovuar kushtetutshmërinë, barazinë dhe eliminimin e diskriminimit.

3. z. Liridon Kurti nuk ka profil bamirësi

Për të kompletuar shkrimin me elemente të forta konspiracioniste, z. Liridon Kurti paraqitet si një bamirës që përmes bamirësisë e rrezikon Kosovën dhe tenton të përhapë islamin politik.

z. Liridon Kurti nuk është paraqitur asnjëherë si bamirës e as nuk ka një profil të tillë. Puna e tij në një organizatë bamirëse, nuk nënkupton se ai përmes ndonjë mënyre të shpërndarjes se të mirave personale materiale, tenton të shtrijë islamin politik në shkolla.

¹ Voll, John O., and Tamara Sonn. *Political Islam: Oxford bibliographies online research guide*. Oxford University Press, 2010. Faqe 5

4. Kërkesa dhe kampanja nuk kanë qenë të drejtuara kundër asnjë rregulloreje

Artikulli thekson se kampanja ka pasur për qëllim ndryshimin e një rregulloreje që interpreton kushtetutën. Është fakt notor se kërkesa dhe kampanja i janë referuar një Udhëzimi Administrativ e jo një rregulloreje. Në hierarkinë dhe në kategorizimin e akteve juridik dallohen rregulloret nga udhëzimet administrative. Ato paraqesin dy lloje të ndryshme të akteve juridike dhe asnjëra e as tjetra nuk mund të shërbejnë për të interpretuar apo kufizuar kushtetutën.

Përfundimisht duhet theksuar se vendosja e kampanjës dhe emrit të z. Liridon Kurti në një artikull që titullohet “Propaganda fetare që kërcënon Kosovën” është deformim i realitetit, sepse kampanja dhe aktiviteti i z. Liridon Kurti në këtë kampanjë në rrjetet sociale ka pasur për qëllim realizimin e një lirie dhe të drejte themelore të garantuar më Kushtetutën e Kosovës.

Nëse për juve kërkesa për realizimin e një lirie dhe të drejte themelore dhe kërkesa për anulim të një dispozite juridike absolutisht të pavlefshme është “propagandë fetare që kërcënon Kosovën” atëherë ju sugjeroj që të konsultoni profesionistët e fushës që ua sqarojnë se ky konstatim i Juaji i pasaktë, përpos që është huqje totale, shpifje dhe keqinformim, në të vërtetë është në të vërtetë propagandë që kërcënon Kosovën dhe paraqet një imazh të rrejshëm të Kosovës në botë.

Prandaj duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm, kërkoj nga Ju që:

1. Të korrigjoni shkrimin tuaj dhe të fshini të pavërtetat ndaj meje
2. Të botoni reagimin tim
3. Të kërkonit falje për keqinformim dhe shpifje.

Me respekt,

Liridon Kurti